REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 535/26 Dt. 13.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Marrëveshjes së Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Fondacionit Allianz dhe Autostrada Biennale, 01 nr. 368/26, të datës 10.08.2026, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit: "Faza e dytë e projektit: Zhvillimi socio-ekonomik përmes turizmit kulturor dhe zgjerimit të hapësirave kulturore", i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 (detyrimet e palëve) të Marrëveshjes së Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Fondacionit Allianz dhe Autostrada Biennale, 01 nr. 368/26, të datës 10.08.2026, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 100.000,00 € (njëqindmijë euro) nga buxheti i vitit 2027.

2. Zyrtare përgjegjëse për mbikëqyrje projektit, nga Komuna e Prizrenit caktohet Laura Kelmendi Selaj.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) të lidhur mes Komunës së Prizrenit, Fondacionit Allianz dhe Autostrada Biennale, 01 nr. 368/26, të datës 10.08.2026.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoritë përkatëse dhe zyrtarja përgjegjëse për zbatimin e vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Drejtorive përkatëse,
- Zyrtares përgjegjëse,
- Fondacionit Allianz,
- Autostrada Biennale,
- Zyrtares përgjegjëse,
- Arkivës së Kryetarit.